

VENDIM I
ORTAKUT TË VETËM
TË
“ZIP CLOUD SHPK”

Sot, më datë 05.04.2023 unë i nënshkruari **Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 09.03.1983, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **Zip Cloud**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“**QKB**”), me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): L61531022M dhe seli në adresën: “*Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Shqipëri*” (në vijim referuar si “**Shoqëria**”),

MEQËNËSE:

- Unë jam ortak i vetëm i kuotës së Shoqërisë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj, me vlerën 100.000,00 (*njëqind mijë*) Lekë;
- Dëshiroj që të transferoj kuotën time të zotëruar në Shoqëri, si kontribut të vlerësuar në para tek shoqëria Noa Holding Sh.p.k. me **NUIS: M31509039J**.

Për sa më sipër, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, vendosa si vijon:

VENDOS:

1. Të transferoj kuotën time në Shoqëri, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerën 100.000,00 (*njëqind mijë*) Lekë, në formën e kontributit të vlerësuar në para tek shoqëria Noa Holding Sh.p.k. me **NUIS: M31509039J**.
2. Kuota do të përfshihet në formën e kontributit të vlerësuar në para në kapitalin e shoqërisë Noa Holding Sh.p.k., në përputhje me vlerën e saj nominale, siç gjendet aktualisht e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB. Si pasojë e këtij kontributi, ortaku i vetëm i Shoqërisë, do të jetë shoqëria Noa Holding Sh.p.k. me **NUIS: M31509039J**.
3. Në përputhje me sa më sipër, ndryshohet neni 7 i statutit të Shoqërisë, si vijon:

“Neni 7

Ortaku i vetem

Kuota e kapitalit zotërohet 100% nga ortaku i vetëm, Shoqëria Noa Holding Sh.p.k.”.

4. Të depozitohet këtë vendim si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm pranë QKB dhe pranë të gjitha autoriteteve ku ky depozitim është i nevojshëm

ORTAKU I VETËM

GENTIAN SULA

Gentian Sula

ZIP CLOUD
NUIS: L61531022M
Tirane - Albania